



VENDIM

Nr. 1 Datë 11/01/2018

**“PËR SHPËRNDARJEN E GRANTIT TË AKORDUAR NGA MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT & RINISË DHE REGJISTRIN E PROKURIMEVE ME BURIM FINANCIM
GRANTI, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE, PËR
VITIN KALENDARIK 2018”.**

Në zbatim të nenit 3, pika 3 dhe nenit 49 e vijim ...të Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i administrimit pasi shqyrtoi materialin dhe vendimin nr. 1, datë 10.01.2018, dërguar nga Senati Akademik si dhe relacionin e paraqitur nga Administratorja e Universitetit të Arteve, Znj. Alma Sinanaj për “Shpërndarjen e grantit të akorduar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe regjistrin e prokurimeve me burim financimi granti”, pas diskutimeve dhe me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Miratimin e grantit të akorduar nga Ministria e Arsimit, Sportit & Rinisë, për vitin kalendarik 2018 në Universitetin e Arteve, sipas relacionit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Shpërndarjen e grantit të akorduar nga Ministria e Arsimit, Sportit & Rinisë, për vitin kalendarik 2018 në Universitetin e Arteve, sipas relacionit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Miratimin e regjistrit të prokurimeve me burim financimi granti, për vitin kalendarik 2018 në Universitetin e Arteve, sipas relacionit bashkëlidhur këtij vendimi.



Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Elira Kokona
(kryetar)

Prof. Artan Peqini
(anëtar)

Prof. Besnik Bisha
(anëtar)

Prof. Arben Basha
(anëtar)

Dhimitër Bako
(anëtar)

Erjon Ndroqi
(anëtar)

Arjan KONOMI
(anëtar)